



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI JURIDIK**

STUDIMET E DOKTORATËS

**PLANPROGRAMI I LËNDËS
"E DREJTA ADMINISTRATIVE E
AVANCUAR"**

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|----------------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti Juridik |
| Titulli i lëndës: | E Drejta Administrative e Avancuar |
| Niveli: | Doktoratë (PhD) |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | 2016/17 |
| Numri i orëve në javë: | |
| Vlera në kredi – ECTS: | 10 |
| Koha / lokacioni: | // |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof.Asoc.Dr. Mirlinda Batalli Prof.Ass.Dr. Agur Sokoli |
| Detajet kontaktuese: | mirlinda.batalli@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | <p>Ky studim do të përfshijë aspekte krahasimore të administratës publike për vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim duke përfshirë edhe administratën publike të Kosovës.</p> <p>Gjithashtu, kjo lëndë shqyrton për studentët aspekte krahasimore të procesit gjyqësor administrativ dhe llojet e sistemeve juridike të kontrollit të veprimtarisë administrative.</p> <p>Vëmendje e posaçme do ti kushtohet edhe procesit të reformimit të administratës e veçanërisht kompjuterizimit të saj si një proces fundamental për një administratë publike moderne.</p> |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Qëllimi i studimit të kësaj lëndë është përqendruar në qasjen teorike dhe praktike të njohjes dhe transformimit të marrëdhënieve shoqërore në përgjithësi dhe të atyre juridike administrative në veçanti. Kjo qasje vë theks të veçantë në institutet më të rëndësishme që studiohen në shkencat administrative.</p> <p>Në zbatimin, ruajtjen dhe forcimin e ligjshmërisë rol të veçantë luajnë organet e administratës dhe organet e specializuara për ushtrimin e kontrollit. Zbatimi i ligjshmërisë nga ana e organeve të administratës kërkon edhe njohjen e garancive që ekzistojnë në vetë sistemin e këtyre organeve ose që janë ndërtuar për sigurimin e zbatimit të ligjit. Studimi përqëndrohet veçanërisht edhe në kuptimin</p> |

e aktit administrativ.

Akti administrativ është një nga format, mund të themi më kryesorja, në veprimtarinë ekzekutive dhe vendimmarrëse të administratës publike. E gjithë veprimtaria ekzekutive e çdo organi administrativ publik konkretizohet përfundimisht në momentin e nxjerrjes së aktit, sepse është akti administrativ, ai që krijon marrëdhënie të reja juridike për subjektet që iu drejtohet, që i ndryshon këto marrëdhënie të krijuara më parë, duke i përsosur më shumë, ose edhe i shuan.

Akti administrativ duhet konceptuar si një deklaram apo shfaqje e një vullneti të qartë të pushtetit shtetëror në veprimtarinë e administratës publike, i kryer në përputhje të plotë me kushtetutën dhe me ligjet në tërësi, për të krijuar, për të ndryshuar apo për të shuar pasoja të caktuara juridike, i zbatuar nëpërmjet vullnetit të lirë të subjekteve që u drejtohet, ose me anë të fuqisë shtrënguese të shtetit. Kontrolli për zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e administratës nga pikëpamja e kriterëve të subjekteve të së drejtës që merren me ushtrimin e tij dhe nga ajo e veçorive juridike që e karakterizojnë paraqitet në këto forma: kontrolli i brendshëm dhe kontrolli i jashtëm. Me kontroll të brendshëm kuptojmë kontrollin që ushtron organi administrativ epror mbi organet vartëse lidhur me kryerjen e suksesshme të detyrave të tyre zyrtare.

Kontrolli i brendshëm është pjesa kryesore në sferën e menaxhimit të institucioneve publike. Ky kontroll përfshin planet, metodat, dhe procedurat që zbatohen për realizimin e misionit, vizionit dhe objektivave të një organizate. Kontrolli i brendshëm duhet të ofrojë një siguri të arsyeshme lidhur me realizimin e objektivave në sferën e efektshmërisë dhe efikasitetit, sigurisë së raporteve të ndryshme financiare, pajtueshmërisë me ligjin dhe aktet nënligjore. Ndërkaq, kontrolli i jashtëm është kontrolli që organet e specializuara ushtrojnë mbi organet e tjera administrative dhe mbi zbatuesit e tjerë, me qëllim të sigurimit të zbatimit të rregullt nga ana e atyre ligjeve e akteve nënligjore të organeve më të larta.

| | | | |
|---|--|-------------|------------------|
| Rezultatet e pritura të nxënies: | Në përfundim të kësaj lënde, synohet që studentët të njohin fushën e së Drejtës Administrative në mënyrë me të detajuar dhe llojet e sistemeve juridike të kontrollit të veprimtarisë administrative me theks të veçantë për gjyqësinë administrative. | | |
| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë | Javë | Gjithësej |
| Ligjërata | 3 | 1/15 | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 1/15 | 30 |
| Punë praktike | 2 | 1/15 | 30 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 3 | 1/15 | 45 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 3 | 3/5 | 15 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 1/15 | 30 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 1/15 | 15 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 3 | 1/15 | 45 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 3 | 1/5 | 15 |
| Projektet,prezantimet ,etj | 3 | 1/10 | 30 |
| Totali | | | 300 |
| Metodologjia e mësimdhënies: | <p>Lënda do të mësohet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajtimit teorik të lendes duke përfshirë edhe metodat bashkëkohore të praktikumit. - Trajtimit komperativ i çështjeve duke evidentuar mangësitë dhe përparësitë në lidhje me këtë fushe në Kosovë dhe mundësitë për reformë. - Trajtimi dhe diskutimi i rasteve konkrete nga veprimtaria e administratës Publike në Kosovë. - Prezantime nga ana e studentëve të temave të caktuara nën mbikëqyrjen e Profesorit dhe hapja e debatit (mësimi interaktiv). - Ushtrimet dhe Seminaret si një proces interaktiv i mësimit për studentët, duke u bazuar në studimin e pavarur të materies nga ana e studentit nën mbikëqyrjen nga ana e mësimdhënësit të lëndës. - Trajtimi i shembujve të ndryshëm me qëllim të lehtësimit dhe të kuptuarit të lëndës nga studentët. | | |
| Metodat e vlerësimit: | Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në | | |

| | |
|--------------------------------|---|
| | <p>vazhdim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i parë 20% ▪ Vlerësimi i dytë 20% ▪ Punimi seminarik, detyrat e shtëpisë, puna praktike ose angazhimet tjera 20% ▪ Vijimi i rregullt 10% ▪ Provimi final 30% <p>- Totali 100%</p> |
| Literatura | |
| <p>Literatura bazë:</p> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Prof. Esat Stavileci, Prof. Mirlinda Batalli, Prof.Sokol Sadushi “E Drejta Administrative – Organizimi dhe Veprimtaria Administrative”, Prishtinë, 2012. 2. Prof. Esat Stavileci, Prof. Agur Sokoli, Prof. Mirlinda Batalli “E Drejta Administrative – Administrata, Kontrolli i punës së Administratës dhe Përgjegjësia Politike e saj, Kompjuterizimi i Administratës”, Prishtinë, 2010. 3. Prof. Agur Sokoli “E Drejta Administrative”, Prishtinë 2014, 4. Paul Craig, “<i>EU Administrative Law</i>”, Volume XVI/1, Oxford University Press, 2006. 5. Frans Greß, Jackson Janes (eds), “<i>Reforming Governance (Lessons from the United States of America and the Federal Republic of Germany)</i>”, Campus Verlag- Frankfurt/New York, Parlage – New York, 2001. 6. Greer Hogan & Rhona Smith, “<i>Core Statutes on Public Law and Human Rights</i>”, Palgrave Macmillan, New York, 2007. 7. Jacques Pertek, “<i>E Drejta e Institucioneve të Bashkimit Evropian</i>”, (Përkthyer nga Dashurije Hasandoçaj, Shtypi Universitar i Francës, 2004. 8. John Dickinson, “<i>Administrative Justice and the Supremacy of Law in the United States</i>”, The LawBook Exchange, LTD. Clark, New Jersey, 2003. 9. Jürgen Rose, Johannes CH.Traut (Editors), “<i>Federalism and Decentralization</i>”, Lit Verlage Palgrave, Hamburg, 2002. 10. Larry Diamond, “<i>Developing Democracy</i> – |

| | |
|----------------------------------|--|
| | <p><i>Toward Consolidation</i>”, The Johns University Press, Baltimore and London, 1999.</p> <ol style="list-style-type: none"> 11. Kval – Mellbey – TranØy, “<i>Politika dhe Demokracia</i>” (botimi i dytë), Përkthyer nga Ermir Paluha, Prishtinë 2006. 12. Michael Harris & Martin Partington, “<i>Administrative Justice in the 21st Century</i>”, Centre for the study of the Administrative Justice, Oxsford and Portland, Oregon, 1999. 13. Prof. Esat Stavileci :Hyrje në shkencat administrative, Prishtinë, 1997. 14. Prof. Esat Stavileci:Nocione dhe Parime të Administratës Publike, Prishtinë 2005. 15. Prof. S. Lilic, P.Dimitrijevic, M. Markovic, Upravno Pravo, Beograd, 2002. 16. East European Constitutional review, published by New Yourk University School f Law and Central European University. 17. E. Pusic, Nauka o upravi, Zagreb, 1996. 18. Emmert, Franc, European Union law , cases, hah-London, Boston, 2000 19. Sokoli Agur, “<i>E Drejta Administrative</i>”, Prishtinë 2014. 20. Sokol Sadushi: E drejta administrative 2, Teoria e Aktit Administrativ, Tiranë, 2000. 21. Ermir Dobjani: E drejta administrative I,Tiranë 2000. |
| <p>Literatura shtesë:</p> | <ol style="list-style-type: none"> 22. Jani.Çomo: E drejta administrative e RPSH, 1983. 23. Robert Dimitrovski, Jove Kekenovski, “<i>Principet e Administratës Publike</i>”, Prishtinë 2006. 24. Parime dhe institucione të së drejtës publike, Tiranë 1993, L. Omari. 25. P.P. Craig:Administrative law-London 1994 26. S.A.De Smith Judicial Review of Administrative Action, 27. Wade, H. R.W.: Administrative Law, New York, 1988. 28. J. C. Ricci: Droit administratif, Paris, 1996. 29. R.M.Chapus: Droit Administrativ-Paris 1992 30. V. de Grutner: Allgemeins verwaltungsrecht, Berlin, 1988. 31. Gianini, M. S.: Istituzioni di diritto |

| | |
|--|--|
| | <p>administrativo, Milano, 1981.</p> <p>32. Savremena administracija, Politicka enciklopedia, Beograd, 1975.</p> <p>33. Instituti i studimeve publike e ligjore, Komentari i Kodit të Procedurës Administrative, Tiranë 2001.</p> |
| | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2. Ligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-189; 3. Ligji për vetëqeverisjen lokale të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040; 4. Ligji për Ndërmarrjet Publike të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-087. 5. Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative të Kuvendit të Kosovës Nr. 05/L -031. 6. Ligji për Konfliktet Administrative të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-202 7. Akte të tjera juridike nga fusha e administratës. |

Plani i dizajnuar i mësimit:

| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
|-----------------------------|---|
| Java e parë: | Shqyrtime gjithëpërfshirëse mbi administratën, administratën shtetërore dhe publike |
| Java e dytë: | Doktrina e së drejtës administrative |
| Java e tretë: | E drejta administrative krahasimore |
| Java e katërt: | Organizimi i administratës shtetërore dhe publike sipas të drejtës pozitive |
| Java e pestë: | Shërbimet publike dhe organizimi i shërbimit civil në Kosovë |
| Java e gjashtë: | Akti administrativ, kuptimi, klasifikimi dhe efektet e aktit |
| Java e shtatë: | Funksioni mbikëqyrës i administratës |
| Java e tetë: | Përgjegjësia politike e administratës |
| Java e nëntë: | Gjendja e administratës publike, problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet |
| Java e dhjetë: | Përsosja e punës në administratën publike. |
| Java e njëmbëdhjetë: | Trendët e kompjuterizimit të administratës në vendet e zhvilluara dhe në zhvillim |
| Java e dymbëdhjetë: | Thjeshtësimi i procedurave administrative, puna e hapur e qeverisë dhe liria e informimit |
| Java e trembëdhjetë: | Administrata publike në Kosovë |

| | |
|------------------------------|-----------------------------------|
| Java e katërbëdhjetë: | E drejta Administrative Evropiane |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Diskutime me studentë |

| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: |
|---|
| <ul style="list-style-type: none">▪ Respektimi i orarit në ligjëratë dhe ushtrime;▪ Mos-lëshimi i sallës gjatë ligjëratave ose ushtrimeve;▪ Ruajtja e integritetit akademik;▪ Ruajtja e disiplinës gjatë procesit mësimor;▪ Respektimi i rregullave gjatë provimit. |